

VENDIM
Nr. 662, datë 26.9.2012

PËR HEQJEN E LICENCËS SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI EUROPIAN I TURIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 pika 8, e 45, pika 4, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës shkollës së lartë private “Universiteti European i Turizmit”, si dhe të lejeve për hapjen e programeve të studimeve në zbatim të saj.

2. Shkolla e lartë private “Universiteti European i Turizmit” të ofrojë mjetet e nevojshme financiare dhe mundësitë për përfundimin e studimeve të filluara për të gjithë studentët që janë të regjistruar në institucion, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë private “Universiteti European i Turizmit” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha